



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 84 Datë, 12.05.2020

MBI

PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN PRILL 2020.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017 i ndryshuar, të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.05.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga “Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Sekretari i Përgjithshëm”, mbi “Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Prill 2020”,

Konstatoi se:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sha, me shkresën nr. 3801 Prot, datë 04.05.2020, ka paraqitur “Aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF), për muajin Prill 2020”.
- Sasia e energjisë elektrike të blerë për muajin prill 2020 për klientët që furnizohen nga FMF është prokuruar në treg të parregulluar.
- Rezulton se janë zhvilluar 3 procedura për blerjen e energjisë nga tregu i parregulluar për muajin Prill 2020.
- Për përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga *Furnizuesi i Mundësisë së Fundit* , janë marrë në konsideratë:
 - **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 198, datë 12.12.2019 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020” është 0.75 lekë/kWh.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV**, bazuar në vendimin nr. 199, datë 12.12.2019 të bordit të ERE-s *“Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020” është 1.5 lekë/kWh.*

- Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë Lekë/Euro të ditëve kur shoqëria ka realizuar procedurat e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar.

Çmimi i FMF-së për muajin Prill 2020

Prill 2020		Njësia	Aplikimi FSHU sh.a.	Perlogaritjet ERE
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	4.432	4.576
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.13</u>	<u>0.14</u>
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh	8.60	8.75

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës llogaritëse rezulton që, çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga *Furnizuesi i Mundësisë së Fundit* për muajin Prill 2020, të jetë **8.75 Lekë/kWh**.
- Neni 8, pika 2 e *“Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”* e ndryshuar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 233, datë 20.12.2019, parashikon se, në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë të klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas vendimit të bordit të ERE-s nr.148, datë 26.12.2014, kur këtë funksion e ushtron OSHEE/ FSHU.
- Në vendimin nr.148, datë 26.12.2014 të bordit të ERE-s, parashikohet se çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët të cilët furnizohen në nivelin e tensionit 35 kV është 9.5 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga *“Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”* prej 9.5 lekë/kWh për muajin Prill 2020.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI